



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0141

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Dardania SH.P.K.”- kundër Vendimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit të Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit” me nr. të prokurimit: "616-23-8866-5-2-1", me 29/04/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Dardania SH.P.K.”- me nr. 2024/141 , kurse vendimi i AK Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit” me nr. të prokurimit: "616-23-8866-5-2-1", ndërsa vendimi i AK-së të mbetet në Fuqi.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Dardania Sh.P.K.”.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me22.08.2023 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit” me nr. të prokurimit: "616-23-8866-5-2-1",. Ndërsa me datën 02.02.2024. ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë GOE “Ermal Sylaj B.I dhe AAB Construction SHPK.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 99,795.00 €.

Me 07.02.2024 OE “Dardania SH.P.K.”- ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 12.02.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.02.2024 OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Dardania SH.P.K.”- me nr. 141/2024 për lidhur me aktivitetin “Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave te betonit” me nr. të prokurimit: "616-23-8866-5-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Dardania SH.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Sqarim hyrës : “Aktiviteti i prokurimit me titull: “Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave te betonit” me nr. të prokurimit: "616-23-8866-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës se Prishtinës, me procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. AK ka kthyer lëndën në rivlerësim, duke rekomanduar për kontratë GOE Ermal Sylaj B.I & AAB Construction Sh.P.K, ndërsa OE ankuesi është eliminuar me arsyetimin: Arsyetim Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ju me ofertën tuaj nuk keni dorëzuar dokumentacionin e kërkuar siç është kërkuar ne DT dhe Njoftimin për kontratë: tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar: 1. Një menaxheri i projektit; kërkohet te jetë Inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi -konstruktiv ose bachelor, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Dëshmia për menaxherin e Projektit, të dorëzohet diploma, CV-ja, Rreferenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij në këtë projekt të noterizuara. Ju si GOE-ik për këtë pike nuk ka dorëzuar Marrëveshjen (Kontratën) e noterizuar për Menaxherin e projektit siç është kërkuar ne DT dhe Njoftim për Kontrate, dhe Ju me ofertën tuaj nuk keni dorëzuar dokumentacionin e kërkuar siç është kërkuar ne DT dhe Njoftimin për kontratë: tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar: 2. Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Dëshmia për inxhinierin e gjeodezisë, të dorëzohet: Diploma, CV-ja, Referenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij në këtë projekt të noterizuara. Ju si GOF.-ik për këtë pike nuk ka dorëzuar Marrëveshjen (Kontratën) e noterizuar për Inxhinierin e Gjeodezisë siç është kërkuar në DT dhe Njoftim për Kontratë, andaj për këtë

aktivitet jeni eliminuar. Tutje, OE ankuesi ka parashtruar ankesë kundër OE të rekomanduarit si dhe kundër arsyeve të eliminimit të tyre. Pas pranimit të qasjes në dokumentet e OE të rekomanduarit, OE ankues pretendon se i njëjti nuk i plotëson kriteret dhe se është i pa përgjegjshëm.

Pretendimi Këtë kërkesë te AK-se nuk e ka plotësuar GOE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar pasi qe asnjëri prej operatoreve te këtij grupi nuk kane kontrata te ngjashme sipas natyrës se këtij aktiviteti te prokurimit ne qasjen ne dokumente qe e kemi marre nga AK pas vendimit te OSHP-se vërtetohet se ky GOE nuk kane asnjë kontratë te ngjashme te përfunduar sipas kërkesës se AK-se pra sipas listës se prezantuar nga asnjë projekt nuk e kane për Mobilizim dhe Demolim te strukturave të betonit shihet qarte se ky GOE është i pa përgjegjshëm dhe AK është dashur qe ta eliminoj e jo ta shpërblej me kontratë. ”

Pretendimi i dytë (II) : “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 3. O.E duhet të ketë se paku pesë (5) punëtorë fizik të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 3. Dëshmia listën e punëtorëve, Certifikatat e kualifikimit dhe marrëveshjen mbi angazhim në këtë projekt. Edhe këtë kërkesë te AK-se nuk e ka plotësuar GOE i rekomanduar për kontrate nuk e ka plotësuar pra nuk ka dorëzuar certifikata te kualifikimit sipas kërkesës se AK-se pasi qe për këta punëtor janë dorëzuar disa certifikata për pjesëmarrje ne një trajnim te sigurisë ne vendin e punës por jo siç është kërkuar qe punëtori te jete i trajnuar për siguri dhe shëndet në punë, kjo është një shembull i certifikatës e bashkangjitur ne ankesë.”

Pretendimi i tretë (III) : “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional: 5. O.E duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për reallizimin e projektit, Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 te DT. I Dëshmia e kërkuar dokumentare: 5. Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje te marrjes me qira) te mjeteve, librezat e qarkullimit dhe Deklaratat unike doganore ose faturat e blerjes për ato automjete qe nuk kane libreza te qarkullimit. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Edhe këtë kërkesë te AK-se nuk e ka plotësuar GOE te rekomanduar për kontratë pasi qe nuk i ka pajisjet te kërkuara sipas aneksit 7 te FDT-se, pra komplet ky OE i mungojnë dëshmitë për pajisjet si me poshtë: Të dorëzohet deklarata doganore apo librezat e qarkullimit apo marrëveshjet për blerjen e pajisjes ose shfrytëzimit të tij.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “Dardaniaa Sh.P.K.”- konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 10, 11, 59, 60, 72 LPP-së. Nga përshkrimi i mësipërm i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, kërkojmë Paneli Shqyrtues i OSHP-së qe te na mbroje te drejtat tona dhe ta detyroj AK-ne qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi lidhur me këtë lloj te aktivitetit te prokurimit dhe te nxjerr: Vendim që të I. Aprovohet, si e bazuar ankesa c

Operatorit Ekonomik Dardaniaa Sh.P.K. Lidhur me aktivitetin e prokurimit: Parku në Kalabri- Faza e I-rë Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit me nr. të prokurimit: 616-23-8866-5-2-1 dhe Nr. i brendshëm: 616 23 156 521 të iniciuar nga AK- Kuvendi 1 Komunës Se Prishtinës. II. Obligohet, Autoriteti Kontraktues AK- Kuvendi i Komunës se Prishtinës. që të zbatoj vendimin e OSHP:2023/0877 të datës 05.01.2024, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: Parku në Kalabri- Faza e I-rë Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit me nr. të prokurimit: 616-23-8866- 5-2-1 dhe Nr. i brendshëm: 616 23 156 521 të iniciuar nga AK- Kuvendi I Komunës së Prishtinës. III. Urdhërohet, Autoriteti Kontraktues AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës. që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh të njoftoj OSHP-në dhe Operatorin Ekonomik Dardaniaa SH.P.K, lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP:2023/0877 të datës 05.01.2024, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: Parku në Kalabri- Faza e I-rë Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave të betonit me nr. të prokurimit: 616-23-8866-5-2-1 dhe Nr. i brendshëm: 616 23 156 521 të iniciuar nga AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim : “Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se vendimi i Panelit Shqyrtues OSHP:2023/0877 ka miratuar ankesën e parashtruesit dhe e ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit. Pra duhet sqaruar se vendimi i OSHP nuk e ka detyruar autoritetin kontraktues që të shpallë fitues parashtruesin ose ndonjë operator tjetër ekonomik pavarësisht kriterit të dhënies të përcaktuar me dosjen e tenderit. Sipas vendimit të OSHP autoriteti kontraktues është detyruar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim ashtu që komisioni për rivlerësim të realizoj ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave. Rrjedhimisht autoriteti kontraktues ka vepruar me përpikmëri sipas vendimit të Panelit Shqyrtues ashtu që e ka kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim ndërsa ka publikuar njoftimin mbi vendimin saktësisht sipas të gjeturave dhe rekomandimeve të komisionit për rivlerësim. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe për këtë arsye është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit si tenderues i papërgjegjshëm.

Parashtruesi pretendimet ankimore i ka ndarë në dy grupe ashtu që disa pretendime i ka drejtuar kundër tenderuesit të rekomanduar ndërsa disa pretendime të tjera i ka drejtuar kundër letrës standarde përmes të cilës parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm nga ky aktivitet të prokurimit. Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar, duhet cekur se parashtruesi në raport me këto pretendime nuk mund të dëshmoj asnjë interes material apo dëm eventual përderisa vet është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm. Rrjedhimisht nuk është palë e interesuar në raport me këto pretendime në kuptim të nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 26 ku përcaktohet se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”. Rrjedhimisht është gjetur se këto pretendime ankimore duhet hedhur poshtë si të palejuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore të drejtuara kundër arsyeve për eliminimin e parashtruesit, sipas letrës standarde përmes të cilës parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm

nga ky aktivitet i prokurimit për arsye se nuk e ka dorëzuar marrëveshjen (kontratën) e noterizuar për menaxherin e projektit si dhe marrëveshjen (kontratën) e noterizuar për inxhinierin e Gjeodezisë. Këto të gjetura të komisionit për rivlerësim i janë referuar kërkesave të dosjes së tenderit të përcaktuara si vijon: 1. Një menaxheri i projektit; kërkohet te jetë Inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi -konstruktiv ose bachelor, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. 1. Dëshmia për menaxherin e Projektit, të dorëzohet diploma, CV-ja, Referenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij në këtë projekt të noterizuara. 2. Inxhinier i diplomuar i Gjeodezisë, me së paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. 2. Dëshmia për inxhinierin e gjeodezisë, të dorëzohet Diploma, CV-ja, Referenca si dhe marrëveshja mbi angazhimin e tij në këtë projekt të noterizuara. Pra fillimisht duhet cekur se as parashtruesi nuk e ka kontestuar drejtpërdrejtë faktin se këto dy marrëveshje janë kërkuar që të jenë të noterizuara. Në anën tjetër është fakt i pakontestueshëm që vërtetimet noteriale të kontratave nuk janë dorëzuar sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Duhet shtuar edhe faktin se parashtruesi dhe ofertuesit e tjerë kanë pasur mundësi që të kontestojnë kërkesat e dosjes së tenderit deri në momentin e hapjes së ofertave. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore lidhur me arsyet për eliminimin e parashtruesit si tenderues të papërgjegjshëm janë pretendime të pabazuara në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet ankimore. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 23.02.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 141/2024, ndërsa me datë 28.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/141 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues është pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit, Ndërsa OE Nuk është pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante

lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Dardaniaa Sh.P.K” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/141 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës: “Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se, OE ankues pretendon se vendimi i panelit shqyrtues e shpallë të pa përgjegjshëm OE të rekomanduar, gjë e cila nuk qëndron, për faktin se ne vendim është potencuar si mëposhtëm citat: Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit me titull “Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave te betonit” të rivlerësohet dhe gjatë rivlerësimit AK të veproj në plotin me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Po ashtu vlenë të theksohet se paneli shqyrtues nuk është lëshuar në asnjë konstatim sa i përket OE të rekomanduar për kontratë për shkak se pala ankimore nuk ka pasur qasje të plotë dhe konform rekomandimeve të ekspertit shqyrtues AK duhet tja lejoj qasjen ankuesit.”

Konstatimi i parë (I): “ Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e parë të OE ankues kundër GOE të rekomanduarit sqaron se, në ofertën e të njëjtit gjendet lista e kontratave të përfunduara e cila përmban kontrata të natyrës së ngjashme, asfaltim, punë ndërtimore në hapësira publike, mbi vlerën 100 000 euro, andaj si e tillë pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.”

Konstatimi i dytë (II) : “Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë sqaron se, në ofertë gjendet lista e stafit, po ashtu edhe certifikatat për pjesëmarrje në trajnim për aftësimin e punëtorëve për punë të sigurt në vendin e punës, për të cilat OE ankues pretendon se këto certifikata nuk janë certifikata të kualifikimit. Mirëpo, që të jemi sa më objektiv në shqyrtimin e pretendimit në fjalë, atëherë kam kërkuar që të konfirmohet certifikimi nga ana e lëshuesit (kompanisë), dhe si e tillë kemi pranuar edhe konfirmim/sqarimin nga ana e lëshuesit të certifikatës citat:Sqarim: Lëshimi i certifikatës nënkupton përfundimin e trajnimit), në kuadër të këtij trajnimi Certifikata është valide si kërkesë ligjore për kompanitë/punëdhënesit pasi qe janë të obliguara të trajnojnë ne lëmin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë të gjithë punëmarrësit e vet, dhe në aspektin kualifikues Certifikata ka karakterin e kërkesës nga Neni 20 I ligjit 04/L-161 për SSHP. Andaj, pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.”

Konstatimi i tretë (III): “Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e tretë sqaron se, AK në DT ka kërkuar:5. O.E duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. 5. Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje te marrjes me qira) te mjeteve, librezat e qarkullimit dhe Deklaratat unike doganore ose faturat e blerjes per ato automjete qe nuk kane librezat te qarkullimit.Vëmendj! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.Tutje, OE i rekomanduar në ofertë ka bashkangjitur një numër të madh të pajisjeve

dhe mekanizmave. Disa i posedon në pronësi dhe disa i posedon me marrëveshje për projektin në fjalë, kurse sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me faturat e blerjes, të cilat nuk janë të dëshmuara me transfer bankar, konsideroj se AK në DT nuk ka të specifikuar këtë kërkesë, konform nenit 52.3 të LPP-së pretendimi nuk është i qëndrueshëm. Ekspertja shqyrtuese tutje thekson, sa i përket pretendimet të OE ankues kundër arsyes së eliminimit nga AK sqarojmë se, lidhur me këto pretendime ankimore, është një vendim paraprak i panelit shqyrtues me nr. 2023/0877 dt: 05.01.2024, të cilat pretendime gjendet të bazuara. Si përfundim, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqarojmë se, ankesa e OE ankues rekomandohet si pjesërisht e bazuar, për faktin se përkundër pretendimeve të OE ankues kundër eliminimit që janë të qëndrueshme, pretendimet e OE ankues kundër OE të rekomanduarit nuk gjenden të bazuara, dhe si e tillë OE i rekomanduar plotëson kriterin me çmimin më të ulët, andaj ky kriter kushtëzon të mbetet në fuqi vendimi.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Dardaniaa Sh.P.K.” Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Dardaniaa Sh.P.K.” janë pjesërisht të bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Parku ne Kalabri- Faza e I-re Mobilizimi dhe Demolimi i strukturave te betonit” me nr. të prokurimit: “616-23-8866-5-2-1”.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “Dardaniaa Sh.P.K.”-te aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuara. Paneli shqyrtues ashtu sikurse Ekspertja shqyrtuese thekson, sa i përket pretendimet të OE ankues kundër arsyes së eliminimit nga AK sqarojmë se, lidhur me këto pretendime ankimore, është një vendim paraprak i panelit shqyrtues me nr. 2023/0877 dt: 05.01.2024, të cilat pretendime gjendet të bazuara, por përkundër pretendimeve të OE ankues kundër eliminimit që janë të qëndrueshme, pretendimet e OE ankues kundër OE të rekomanduarit nuk gjenden të bazuara, dhe PSH mbështet përveç arsyetimit dhe përgjigjeve në pretendime ankimore edhe rekomandimin e ekspertës shqyrtuese se OE i rekomanduar plotëson kriterin me çmimin më të

ulët, andaj ky kriter kushtëzon të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtën AK dhe që do të jetë në fuqi vendimin e AK, vendim ky që është vendimi i një komisioni i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: “Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin të plotë të plotë individuale për veprimet e kryera të ofertës”, atëherë në përbimë të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta zgjasë aktivitetin e prokurimit. Edhe më tutje dhe pa ndonjë arsye konkrete dhe në ndonjë argument të bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se është në përfundim të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontratave edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i ligjit është mes tjerash, cituar: “...të sigurtë integritetin dhe përgjegjësinë e tyre. zyrtarëve, nëpunësve civilë dhe të tjerëve që kryejnë janë të përfshira në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e tyre janë të tilla dhe baza ligjore faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo - diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të të gjitha këto procedurale dhe qenësore të ligji”.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e ekspertëve.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të mbetet në fuqi vendimi i AK, po ashtu, në kuptim të nenit 6 dhe 7 të LPP aplikimi i devijimeve të vogla siç përcakton edhe legjislacioni në fuqi konkretisht neni 59 par. 4 të LPP-së, ku përgjegjesin ja atribuon autoritetit kontraktues, andaj mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit Kontraktues aplikimi i kësaj norme, ashtu siç e përcakton edhe dispozita e referuar.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e

tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë me poentim në raport me ofertën e ankuesit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - DARDANIAA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: